

Special Prosecution Office of the Republic of Kosovo
Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës
Kancelarija Specijalnog Tužilaštva Republike Kosovo

Prishtinë, 18 Shkurt 2011

PPS 117/2010

Gjykatës së Qarkut të Mitrovicës/Mitrovica

Sipas Nenit 304 (1), 305 dhe 306 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK)
Prokurori i caktuar shtron këtë:

Aktakuza

Kundër:

Emri dhe Mbiemri	Shaban Hoti
Pseudonimi:	Nuk ka
Data e lindjes	24.09.1971
Vendi i lindjes	Polac, Skenderaj
Emri i babait:	██████████
Emri i nënës:	██████████
Profesioni	I papunësuar
Vendi i banimit	Skenderaj

Për krimet në vazhdim:

- 1) **Krime lufte kundër popullatës civile**, që specifikohet dhe dënohet nga **Neni 22 dhe 142 të Kodit Penal të Republikës Federative Socialiste të Jugosllavisë (KPRFSJ)**, momentalisht i dënueshëm nën Nenin 23 dhe 120 të Kodit Penal të Kosovës (KPK), pasi që në shkelje të **Nenit 3 sipas** katër Konventave të Gjenevës të datës 12 Gusht 1949 dhe të **Neneve 5 dhe 5(1) të Protokolit II** të datës 8 Qershor 1977, si shtesë të Konventës së Gjenevës të vitit 1949 (AP II), të gjitha rregullat e ligjeve ndërkombëtare të aplikueshme në kohën e konfliktit të armatosur të brendshëm në Kosovë dhe gjatë gjithë kohës relevant me Vendimin e tanishëm, **i akuzuari**, në detyrën e tij si anëtarë i UÇK-së, në bashkëveprim me Sali Rexhepin, Haki Hajdarin dhe dy anëtarë tjerë të pidentifikuar të UÇK-së kanë torturuar Dëshmitarin N, një Shqiptar Kosovar civil i mbajtur në kampin e Cahanit, duke u munduar të marrin informata dhe pranim nga ai duke e rrahur në mënyrë të vazhdueshme me shkopinj druri **në Cahan (Shqipëri) me ose rreth 3 Maj 1999**.
- 2) **Krime lufte kundër popullatës civile**, që specifikohet dhe dënohet nga **Neni 22 i 142 të (KPRFSJ)**, momentalisht i dënueshëm nën Nenin 23 dhe 120 të Kodit Penal të Kosovës (KPK), pasi që në shkelje të **Nenit 3 dhe Nenit 4 dhe 5(1) të**

APII, të gjitha rregullat e ligjit ndërkombëtar të zbatueshëm në kohën e konfliktit të armatosur të brendshëm në Kosovë dhe gjatë gjithë kohës relevant me Vendimin e tanishëm i akuzuari në pozitën e tij si anëtarë i UÇK-së në bashkëveprim me Sali Rexhepin dhe një anëtarë tjetër të paignifikuar të UÇK-së kanë torturuar Dëshmitarin N, një Shqiptar Kosovar civil të ndaluar në Kampin Cahan; më saktë i akuzuari ka marrë pjesë në krim duke u munduar të marrë informata dhe pranim nga Dëshmitari N përderisa ushtari i paignifikuar i UÇK-së e rrahtë atë me një shkop druri në duart dhe këmbët e tij **në Cahan (Shqipëri) me ose rreth 9 Majit 1999.**

BAZAT PËR AKTAKUZË DHE PËRMBLEDHJE E DËSHMIVE

1. Hetimi në rastin e tashëm rrjedhin nda deklaratat e mbledhur nga disa dëshmitarë (Dëshmitari L, Dëshmitari N, Dëshmitari K, Dëshmitari M) gjatë hetimit PPS 08/09 kundër Sabit Geci dhe të tjerët me rëndësi të veçantë ndaj hetimit të tanishëm janë deklaratat të dhëna nga Dëshmitari N me 10 dhe 16 Mars 2010.
2. Dëshmitari N për më shumë ishte marrë në pyetje si dëshmitarë nga Prokurori i caktuar me 2 Dhjetor 2010. Duke u bazuar në deklaratat e tij shtesë, një hetim i ri ishte hapur kundër Haki Hajdarit dhe Sali Rexhepit.
3. Dëshmitë e mbledhura dhe në veçanti deklaratat e dhëna nda Dëshmitari L, Dëshmitari N, Dëshmitari K, Dëshmitari M gjatë hetimit Nr. 08/09 mundëson Prokurorin që të arrijë në përfundim se në vitin 1999 UÇK ka udhëhequr me një kamp ushtarak të përbërë nga disa baraka me lokacion në Cahan (Komuna e Krumes, Shqipëri).
4. UÇK-ja ka përdorur disa objekte brenda kampit për të ndaluar disa persona duke përfshirë edhe civil si Dëshmitari N, Dëshmitari L, Dëshmitari M dhe Dëshmitari K. Të burgosurit e mbajtur në Cahan kanë qenë cak i abuzimit mendor dhe fizik në forma të ndryshme. Të burgosurit i janë nënshtruar rrahjeve të rënda, torturës, izolimit dhe janë mbajtur në një hapësirë të ngjeshur, jo të shëndetshme dhe të papastër.
5. Dëshmitari N ka dëshmuar se pas arritjes në Cahan me ose rreth 3 Majit 1999 ai është rrahur nga Haki "Drenica", Sali "Berisha", Shaban Hoti dhe 2 ushtarë tjerë të UÇK-së të cilët mbesin të panjohur.
6. Këta pesë persona së pari kanë lidhur duart e Dëshmitarit N pash shpinës dhe kanë larguar këpucët dhe çorapet e tij. Më pastaj 4 nga ta duke përfshirë Haki "Drenicën", Sali "Berishën" dhe Shaban Hotin me përjashtim të personit të pestë të panjohur kanë rrahur këmbët dhe shputat e tij me shkopinj druri. Dëshmitari N ka rrënë përtokë dhe nuk ka mundur të lëvizë. Të rrahurat kanë qenë të përcjellura me të marrur në pyetje lidhur me gjoja anëtarësinë e viktimës në Partinë Socialiste Serbe dhe për gjoja anëtarësinë e gruas së tij në LDK. Si pasojë e dhimbjeve të mëdha në këmbë dhe shputa për pesë ditët në vazhdim Dëshmitari N ka mundur vetëm të zvarritet pasi që nuk ka qenë në gjendje të ecë.
7. Në vazhdim Dëshmitari N po ashtu ka dëshmuar se pesë ose gjashtë ditë pas rrahjes së parë pra me 8 ose 9 Maj 1999 ai është rrahur nga një person i panjohur. Sali "Berisha" dhe Shaban Hoti kanë qenë prezent dhe gjatë kohës që personi i panjohur e rrahtë me shkop druri në këmbë dhe duar ata i bënë pyetje. Personi i panjohur gjithashtu bënte pyetje përderisa e rrahte në të njëjtën kohë.
8. Kur i është paraqitur një fotografi me prezantim të Shaban Hotit, dëshmitari N ka

treguar drejt fotografisë së Shaban Hotit duke thënë se e njihnte këtë person por nuk ka qenë i sigurt nëse e ka parë në Cahan.

9. Me 1 Shkurt 2011 WCIU i ka paraqitur Prokurorit të caktuar me një dokument të konfiskuar gjatë bastisjes të bërë në shtëpinë e banimit të Riza Alisë me 23.6.2010. Dokumenti titullohej “Lista e mbikëqyrësve dhe ushtarëve në Cahan’ dhe shënonte trembëdhjetë numra nga të cilët Riza Alija dhe Sali Rexhepi ishin të parët. Lista poashtu shënonte nën numrin 4 emrin e Shaban Hotit, i lindur me 24.09.1971, vendi i lindjes dhe i banimit në Polac (Skenderaj), me shënimin “Ushtar i UÇK-se 15.07.1988”.

10. Gjatë marrjes në pyetje si i dyshuar nga prokurori i caktuar me 18 Shkurt 2011, Shaban Hoti ka konfirmuar se në fund të vitit 1998 deri në fund të Prillit 1999 ai ka qenë ushtar i UÇK-së i caktuar në kampin e Cahan-it. Ai ka shtuar se roli i tij ka qenë të pastrojë armët, të kujdesej për kuajt, të ngarkonte armët në kuaj dhe pastaj ti përcillte deri në kufi me Kosovën.

11. Përderisa Zt.Hoti deklaroi se nuk i kujtoheshin emrat e ushtarëve tjerë të UÇK-së që ishin në Cahan ai ka identifikuar Haki Hajdarin në një shfaqje të fotografive si dikë që e shihte në Cahan afërsisht çdo të tretën ditë dhe që sjellte furnizim me arme dhe uniforma.

* * * * *

12. Ka të dhëna të mjaftueshme të brendshme dhe ndërkombëtare që të dyja dëshmojnë se në Mars të vitit 1999 ka patur konflikt të brendshëm ndërmjet UÇK-së dhe forcave Serbe në territorin e Kosovës.

13. Fakti se këto vepra kanë ndodhur jashtë teritorrit të Kosovës, sic ka vendosur Gjykatësi Konfirmuese tanimë ka vendosur në rastin PPS 08/09 kundër Sabit Gecit dhe të tjerët nuk përjashton aplikueshmërinë e Nenit të Përbashkët 3 dhe ligjit ndërkombëtar humanitar në përgjithësi.

14. Veprimet e të akuzuarit prandaj paraqesin shkeljen e Krimeve të Luftës kundër popullatës civile, duke pasur parasysh se ato shkelin në mënyrë të qartë dispozitat e Nenit 22 dhe 142 të KPRFSJ (të njëjtat vepra po ashtu dënohen nën Nenin 23 dhe 121 paragrafet 2 të KPK) dhe shkel Nenin 3 të përbashkët në Katër Konventa të Gjenevës të datës 12 Gusht 1949 dhe Nenit 5 të Protokolit II të 8 Qershorit 1977 si shtesë ndaj Konventave të Gjenevës të vitit 1949, të gjitha rregullat e ligjit ndërkombëtar të zbatueshme në kohën e konfliktit të brendshëm në Kosovë.

15. Në fund mund të ketë pak dyshim që viktimat e veprimeve të Shaban Hotit kanë qenë civil që nuk kanë marrë pjesë në asnjëfarë armiqësie, që kanë qenë cak për shkak të tradhtisë së tyre reale, të perceptuar ose të pretenduar ndaj UÇK.

PROPOZIM PËR GJYKIM

Prokurori propozon që gjykimi kryesor në këtë rast të caktohet dhe mbahet në Gjykatën e Qarkut në Mitrovicë/Mitrovica.

Prokurori kërkon që personat e mëposhtëm të ftohen për të marrë pjesë:

- Prokurori i caktuar;
- I akuzuari Shaban Hoti, dhe avokati i tij mbrojtës;
- Palët e dëmtuara Dëshmitari N, Dëshmitari L, Dëshmitari K dhe

Dëshmitari M.

Prokurori propozon që gjatë gjykimit kryesor të dëgjohen dëshmitarët e mëposhtëm:

- Dëshmitari N
- Dëshmitari L
- Dëshmitari K
- Dëshmitari M

Prokurori në fund propozon që deklaratat e të akuzuarit të pranohen si dëshmi.

PROPOZIM PËR BASHKIM TË GJYKIMIT

Prokurori propozon që sipas Nenit 33(6) të KPPK gjykimi i tanishëm kundër Shaban Hotit të bashkohet me gjykimin kundër Haki Hajdari dhe Sali Rexhepi pasi që veprimet me të cilat akuzohen tre të akuzuarit janë kryer në bashkëveprim dhe dëshmitë janë tërësisht të përbashkëta.

Maurizio Salustro

SPRK Prokuror